

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P nr. 320/2007

01 dhjetor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Christine Lindemann-Proetel si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Nikolay Entchev si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Tara Khan, zyrtare ligjore e EULEX-it, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër **SYLEJMAN HASANI**,

Shpall si në vijim:

AKTGJYKIM

Akuza për vrasje në kundërshtim me Nenin 30 të Ligjit Penal të Kosovës kundër:

SYLEJMAN HASANI, i biri i Hazir Hasanit dhe Zehide Kajtazit, i lindur më 27 qershor 1957 në fshatin Broboniq të Komunës së Mitrovicës, aktualisht me vendbanim në rrugën "Dëshmorët e Kombit" nr. 707, në fshatin Shipol, Mitrovicë, shqiptar Kosovar;

REFUZOHET sipas nenit 389, Pika (3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,

sepse i akuzuari ishte dënuar më parë për të njëjtën vepër, për vrasjen e Beshir Sheremetit më 18 gusht 1997 rreth orës 20:00 në rrugën "Dëshmorët e Kombit" në Shipol, me aktgjykim të formës së prerë.

Në pajtim me nenin 103 Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 99 paragrafi (2) nënparagrafi 1 deri 5, shpenzimet e domosdoshme të të pandehurit si dhe kompenzimi dhe shpenzimet e avokatit mbrojtës, sikurse edhe shpenzimet e përkthimit, do të paguhen nga fondi buxhetor.

Tara Khan
Procesmbajtëse



Christine Lindemann-Proetel
Kryetare e Trupit Gjykues